



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Raport përmbledhës i vlerësimit ad-hoc të Universitetit Veror Ndërkombëtar "UNISUM"


Korrik 2025

Qëllimi i pyetësorit të vlerësimit ad-hoc të UNISUM, është të vlerësojë përvojën dhe kënaqësinë e studentëve në lidhje me organizimin e universitetit veror të organizuar në universitetin “Haxhi Zeka”. Pyetësi synon të përmbledhë mendimet dhe perspektivat e studentëve, duke përfshirë të gjitha aspektet relevante për të ndihmuar në përmirësimin e organizimit të përgjithshëm të universiteteve ndërkombëtare në të ardhmen, në universitetin “Haxhi Zeka”.

Pyetësi përmban gjithsej 8 pyetje, prej të cilave 6 janë me mundësi përgjigje alternative ku të anketuarit zgjedhin një opsion të caktuar nga një listë përgjigjesh të paracaktuara, ndërsa 2 pyetje janë të hapura. Pyetësi është plotësuar përmes kodit QR nga gjithsej 36 pjesëmarrës.


Rezultatet e vlerësimit

1. Në pyetjen: **Si e vlerësoni përvojën tuaj si student në Universitetin Veror të Universitetit “Haxhi Zeka”?** Rezultatet tregojnë një nivel shumë të lartë kënaqësie nga studentët për përvojën e tyre në Universitetin Veror të Universitetit “Haxhi Zeka”. Shumica absolute (**66.7%**) e kanë vlerësuar përvojën si **“shkëlqyeshëm”**, që tregon se pritshmëritë e tyre janë plotësuar ose tejkaluar. Rreth **28%** e kanë vlerësuar **“shumë mirë”**, që po ashtu është një vlerësim pozitiv. Vetëm **5%** kanë dhënë vlerësimin **“mirë”**, ndërsa nuk ka asnjë vlerësim **“mjaftueshëm”** apo **“dobët”**. Në përgjithësi, përvoja e studentëve është vlerësuar jashtëzakonisht pozitivisht, duke reflektuar një organizim të suksesshëm, përmbajtje të vlefshme akademike dhe angazhim të mirë të stafit dhe pjesëmarrësve (grafiku 1).




Grafiku 1

2. Në pyetjen: **Cili është vlerësimi juaj për cilësinë e kurseve të ofruara në Universitetin Veror?** Nga rezultatet vërehet se shumica e pjesëmarrësve (**50%**) e kanë vlerësuar cilësinë e kurseve si **“shumë të lartë”**, **41.7%** e kanë vlerësuar si **“të lartë”**, ndërsa një pjesë më e vogël (**8.3%**) ka dhënë vlerësim neutral. Nuk janë shënuar vlerësime negative. Këto të dhëna tregojnë një perceptim përgjithësisht pozitiv për cilësinë e kurseve të ofruara. Përqendrimi i lartë i vlerësimeve në kategoritë “e lartë” dhe “shumë e lartë” tregon se pjesëmarrësit kanë qenë kryesisht të kënaqur me përmbajtjen dhe mënyrën e organizimit të kurseve, ndërsa vlerësimet neutrale mund të ndihmojnë në identifikimin e aspekteve që kërkojnë përmirësim në të ardhmen. Në përfundim, mund të thuhet se cilësia e kurseve është vlerësuar pozitivisht nga pjesëmarrësit, me hapësirë për reflektim dhe zhvillim të mëtejshëm bazuar në përvojat individuale të studentëve (grafiku 2).




Grafiku 2

3. Në pyetjen: **A keni arritur të përfitoni njohuri të reja gjatë kursit/universitetit veror?** Një numër i madh i pjesëmarrësve (**61.1%**) kanë deklaruar se kanë përfituar **shumë njohuri të reja** gjatë kursit/universitetit veror. Kjo tregon se programi ka qenë i strukturuar mirë dhe ka ofruar përmbajtje të vlefshme, praktike dhe tërheqëse për pjesëmarrësit. Një pjesë tjetër e konsiderueshme e pjesëmarrësve (**38.9%**) vlerëson se ka përfituar **në një masë të mirë njohuri të reja**, gjë që tregon se përvoja ka qenë pozitive, edhe pse jo në nivel maksimal për të gjithë. Mungesa e përgjigjeve në kategoritë tjera tregon se asnjë pjesëmarrës nuk ka mbetur i pakënaqur ose indiferent ndaj përmbajtjes së kursit (grafiku 3).




Grafiku 3

4. Në pyetjen: **A ju ka pëlqyer kombinimi i ligjëratave, një javë online dhe javën tjetër fizikisht? Rreth 77% e studentëve kanë deklaruar se po, ndërsa 23% kanë thënë jo.** Ky rezultat tregon se shumica e studentëve e kanë pranuar pozitivisht modelin e mësimit të kombinuar, i cili ndërthur javët online me ato me prezencë fizike. Studentët duket se e vlerësojnë fleksibilitetin dhe mundësinë për të ndjekur ligjëratat në formate të ndryshme. Megjithatë, një pjesë më e vogël e studentëve (23%) ka shprehur mendimin e kundërt, që mund të lidhet me preferencat për mësimin tradicional. Modeli i kombinuar shihet si i pranueshëm dhe i efektshëm për shumicën, por është e rekomandueshme të merren parasysh nevojat dhe sugjerimet e studentëve që preferojnë një format tjetër (grafiku 4).




Grafiku 4

5. Në pyetjen: **A do t'iu rekomandonit të tjerëve Universitetin Veror të Universitetit "Haxhi Zeka"?** Shumica e pjesëmarrësve (**91.7%**) e rekomandojnë Universitetin Veror **"me bindje"**. Kjo tregon që pjesa më e madhe e studentëve kanë një përvojë të kënaqshme dhe janë të gatshëm ta sugjerojnë programin te të tjerët. Një pjesëmarrës (**2.8%**) e rekomandon me rezervë, që tregon një dyshim apo pakënaqësi të vogël. Ky është një sinjal i vogël për të kuptuar arsyet e rezervës dhe për të përmirësuar përvojën. Dy persona (**5.5%**) nuk janë të sigurt nëse do ta rekomandonin, gjë që tregon që disa pjesëmarrës mund të kenë pasur përvoja neutrale ose nuk janë të bindur plotësisht për përfitimet e programit. Nuk ka asnjë përgjigje negative, që do të thotë se askush nuk ka refuzuar ta rekomandojë Universitetin Veror (grafiku 5).



Grafiku 5

6. Në pyetjen: **Si do ta përshkruanit sjelljen dhe disponueshmërinë e stafit të universitetit ndaj studentëve?** Shumica e pjesëmarrësve (**75%**) e perceptojnë stafin si **"shumë miqësor dhe ndihmues"**, ndërsa **22.2%** e vlerësojnë si **"miqësor dhe ndihmues"**. Vetëm 1 pjesëmarrës e ka vlerësuar si **"pak miqësor dhe ndihmues"**, dhe nuk ka asnjë vlerësim negativ. Ky rezultat tregon një perceptim pozitiv për stafin e universitetit. Nuk ka asnjë reagim negativ, gjë që tregon se stafi është i përkushtuar dhe i gatshëm për të ndihmuar pjesëmarrësit (grafiku 6).



Grafiku 6

REKOMANDIMT PËR PËRMIRËSIM NGA KËSHILLI PËR MENAXHIM TË CILËSISË DHE VLERËSIM

- Rekomandohet Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar që të bëjë një informim më të detajuar mbi planet dhe aktivitetet, duke u mundësuar përgatitje më efikase pjesëmarrësve.
Afati i implementimit: Në organizimin e UNIWIN 2026!
- Rekomandohet Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar që të harmonizojë orarin e kurseve, me qëllim që të shmanget përputhja e kurseve të njëkohshme.
Afati i implementimit: Në organizimin e UNIWIN 2026!
- Rekomandohet Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar që të organizojë ligjëratat fizikisht.
Afati i implementimit: Në organizimin e UNIWIN 2026!